



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0021467-3/26 dt. 29.04.2026

Mitrovicë

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, dhe nenin 40, paragrafi 2, nënparagrafi c, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 8, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 10/L-001 Mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 (GZ Nr. 04/2026, 02.03.2026.); neneve 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe 46, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, të Statutit të Komunës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 29.04.2026, pasi shqyrtoi Kërkesën Nr.02-400/03-018797/26 dt. 08.04.2025 Për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 dhe viteve paraprake në buxhetin e vitit 2026, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0018345-3/26, dt. 20.04.2026), sjell këtë:

VENDIM

Për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 dhe vitet paraprake në buxhetin e vitit 2026

1. MIRATOHET Vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 dhe vitet paraprake në buxhetin e vitit 2026.
2. Shuma e mjeteve të bartura sipas pikës 1. të këtij Vendimi është 1.229,563.36 €.
3. Nga Shuma e cekur në pikën 2 të këtij Vendimi, shuma prej 934,563.36 € destinohet për kategoritë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime, në programet/nënprogramet:
 - 3.1 Zhvillimi Ekonomik (48022) në vlerë 804,563.36 €;
 - 3.2 Inspektime (16643) në vlerë 80,000.00 €;
 - 3.3 Menaxhimi i katastrofave natyrore (18466) në vlerë 30,000.00 €;
 - 3.4 Zyra e kuvendit(16922) në vlerë 20,000.00 €;
4. Nga Shuma e cekur në pikën 2 të këtij Vendimi, shuma prej 295,000.00 € destinohet për kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, në nënprogramet:
 - 5.1 Administrata e përgjithshme (16322), në vlerë 75,000.00 €.
 - 5.2 Shërbimet Kulturore (85022), në vlerë 80,000.00 €.
 - 5.3 Bujqësia (47022), në vlerë 90,000.00 €.
 - 5.4 Shërbimet Sociale (75606), në vlerë 50,000.00 € dhe
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL-së
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
- Të gjitha drejtorive

Kryesuesi i Kuvendit
Safet KAMBERI